



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

S- 052

Prishtinë, më 16 dhjetor 2008, në orën 14:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
16 DHJETOR 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xheziar Murati**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 100 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se në bazë të Vendimit të Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe të legjislacionit lidhur me të, sipas procedurës së veçantë, datë 15 shkurt 2008, seanca e sotme plenare do të zhvillojë punimet me këtë

R e n d d i t e:

I. Shqyrtimi i dytë i Grupit të tetë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të huajt;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës;
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Konsullor të Misionëve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Komisionit ad-hoc që para deputetëve të Kuvendit t'i arsyetojë rekomandimet për projektligjet në fjalë.

Deputeti **Ramadan Gashi**, i arsyetoi Rekomandimet e Komisionit ad-hoc për të gjashtë projektligjet.

Komisioni Ad hoc, në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës, datë 15 shkurt 2008, në mbledhjet e mbajtura më 15 dhe 16 dhjetor 2008, ka shqyrtuar grupin e tetë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, të miratuara, në parim, në seancën plenare të mbajtur më 15 dhjetor 2008, dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Komisioni vendosi t'i rekomandojë Kuvendit që ta miratojë Projektligjin për të huajt, Projektligjin për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplommatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës, Projektligjin për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, në formën e propozuar.

Komisioni, vendosi t'i rekomandojë Kuvendit ta miratojë Projektligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi, me amendamentet e propozuara.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të huajt

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për të huajt.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 87,
Kundër----- 2,
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për të huajt.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë, me amendamentet e propozuara.

Kryetari hodhi në votim amendamentet e propozuara nga Komisioni ad-hoc në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi amendamentet: 1, 2, 3 dhe 4.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 43,
Kundër----- 21,
Abstenime-----22.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë, me një amendament.

Kryetari hodhi në votim amendamentin e propozuar nga Komisioni ad-hoc në Projektligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi amendamentin 1.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentin e miratuar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 85,
Kundër----- 4,
Abstenime-----8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 76,
Kundër----- 4,
Abstenime-----12.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 85,
Kundër----- 3,
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplommatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplommatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 86,
Kundër----- 3,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplommatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale